

Llogaritë Kombëtare Tremujore

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	6
5. Periudha e referencës	6
6. Mandati institucional.....	6
7. Konfidencialiteti	7
8. Politika e botimit.....	8
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	8
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	8
11. Manaxhimi i cilësisë	9
12. Rëndësia.....	10
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	10
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	11
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	11
16. Kostoja dhe ngarkesa	12
17. Rishikimi i të dhënave.....	12
18. Përpunimi statistikor	13
19. Komente.....	16
Aneks	16

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Llogarive Kombëtare tremujore, Drejtoria e Statistikave të Sektorit Real
1.3. Personi i kontaktit	Arbër Memoçi
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës, Sektori i Llogarive Kombëtare Tremujore
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	amemoci@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	11.05.2022
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	11.05.2022
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	11.05.2022
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Llogaritë Kombëtare pasqyrojnë zhvillimet makro-ekonomike të një vendi dhe i ofrojnë përdoruesve tregues kryesor dhe informacion bazë për zhvillimin ekonomik të tij. Ato tregojnë se sa është kapaciteti prodhues i vendit, sa konsumohet, investohet dhe shkëmbehet me vendet e tjera të botës. Të dhënat e llogarive kombëtare lidhen me të gjitha të dhënat e prodhuara dhe të shpërndara për një ekonomi sipas përkufizimeve dhe udhëzimeve të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010). Një nga treguesit kryesor të llogarive kombëtare është norma e ndryshimit të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) të axhustuar me efektin e çmimeve, i cili tregon zhvillimin ekonomik të një vendi, të rajonit dhe njihet gjithashtu si normë e rritjes ekonomike.</p> <p>Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) përfaqëson vlerën totale në para, të të gjithë të mirave dhe shërbimeve të prodhuara gjatë një periudhe specifike nga njësitë prodhuese rezidente brenda territorit ekonomik të një vendi.</p> <p>Metodat kryesore të llogaritjes së PBB-së janë:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Metoda e Prodhimit; - Metoda e Shpenzimeve; - Metoda e të Ardhurave. <p>INSTAT kryen vlerësimin e PBB-së Tremujore sipas metodës të prodhimit dhe komponentët kryesorë me metodën e shpenzimeve me çmime korente dhe konstante.</p>
<p>3.2. Sistemi i klasifikimit</p>	<p>ESA 2010 ofron një metodologji mbi standardet e zakonshme, përkufizimet, klasifikimet e harmonizuara ndërkombëtarisht dhe rregullat e kontabilitetit që përdoren për përpilimin e llogarive kombëtare në baza të krahasueshme. Kapitulli 12 parashtron parimet kryesore dhe karakteristikat e llogarive kombëtare tremujore.</p> <p>Kapitulli 23 i ESA 2010 përcakton mënyrën me të cilën të dhënat e integruara në skedarë, kodifikohen dhe agregohen sipas niveleve të kërkuar për vlerësimin e Llogarive Kombëtare tremujore.</p> <p>Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare tremujore janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nomenklatura e veprimtarive ekonomike Rev. 2 - NVE Rev. 2; • Nomenklatura e produkteve - NP; • Klasifikimi i konsumit individual sipas përdorimit – COICOP.
<p>3.3. Mbulimi i sektorit</p>	<p>Llogaritë kombëtare përshkruajnë ekonominë gjithsej të një vendi. Të gjitha njësitë që kanë qendrën e tyre të interesit mbizotërues ekonomik në territorin ekonomik të këtij vendi, janë të përfshira. Publikimi i serive tremujore ka si objektiv kryesor që të japë një vlerësim koherent për ecurinë e ekonomisë. Këto seri përfshijnë vlerësime të P.B.B-së tremujore me çmime konstante (ndryshimet në volum të P.B.B-së tremujore), në të cilin përfshihen në vlerësim taksat dhe subvencionet (taksat neto) mbi produktet. Llogaritjet me çmime konstante janë të shprehura me çmimet mesatare të vitit të mëparshëm dhe të lidhur-zinxhir (chainlinking), në vitin referencë, (2010=100). Vlerësimet për P.B.B-në tremujore janë bërë mbi të dhënat e pa zhveshura nga efektet sezonale si dhe mbi të dhënat e zhveshura nga efektet sezonale. Metoda që është përdorur për të vlerësuar P.B.B-në tremujore konsiderohet një metodë indirekte.</p> <p>Konsiderohet si një metodë indirekte sepse të dhënat tremujore që disponohen përdoren për të vlerësuar vlerën e shtuar tremujore duke u bazuar në raportet që zënë këta tregues. Kjo metodë bazohet në supozimin se për periudhën të cilën po analizojmë, raporti midis vlerës së shtuar dhe prodhimit është konstant. Në disa degë specifike si Energjia elektrike, Administrata Publike, Arsimi, Shëndetësia dhe Aktivitetet financiare përdoret metoda direkte e cila bën vlerësime të prodhimit dhe konsumit ndërmjetës më vete, diferenca e të cilëve jep si rezultat vlerën e shtuar.</p>
<p>3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime</p>	<p>Të gjitha konceptet statistikore dhe përkufizimet që do të përdoren në llogaritë kombëtare tremujore përshkruhen në Shtojcën A të Rregullores ESA 2010.</p> <p>Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB): Prodhimi i brendshëm bruto, vlerësuar me çmimet e tregut, është rezultati final i aktivitetit të prodhimit nga njësitë rezidente prodhuese gjatë një viti. Ai është llogaritur sipas dy mënyrave:</p> <p>PBB me mënyrën e prodhimit, është i barabartë me shumën e vlerave të</p>

shtuara bruto sipas degëve të ndryshme të aktiviteteve, duke shtuar tatimet e taksat e duke i zbritur subvencionet mbi produktet (të cilat nuk u janë shpërndarë sektoreve apo degëve të aktivitetit);

PBB sipas mënyrës së shpenzimeve, është i barabartë me përdorimet finale të brendshme të produkteve e shërbimeve (konsumi final efektiv, formimi bruto i kapitalit fikse, ndryshimet e gjendjeve), plus eksportet, minus importet.

Prodhimi: Aktivitet i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale që kombinon burimet në fuqi punëtore, kapital dhe produkte e shërbime për të prodhuar produkte ose kryer shërbime. Proceset e pastra natyrore pa ndërhyrjen ose kontrollin e njeriut nuk bëjnë pjesë në prodhim. Ekzistojnë tre lloje të prodhimit: prodhim tregu; prodhim i prodhuar për konsum final vetjak dhe prodhim tjetër jo-tregu.

Konsumi i ndërmjetëm: Vlera e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit. Përdorimi i aktiveve fikse të vëna në punë nuk merret parasysh; ai evidentohet në konsumin e kapitalit fikse.

Vlera e shtuar bruto: Vlera e shtuar bruto përfaqëson kontributin e aktiviteteve të ndryshme në PBB dhe llogaritet si diferencë midis prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm.

PBB nominale mat vlerën e produkteve për një periudhë të caktuar kohore, me çmimet e periudhës në të cilin prodhohet produkti (çmimet e tanishme).

PBB reale mat produktin total të prodhuar në një ekonomi, për një periudhë të caktuar kohore, por duke marrë parasysh çmimet e një viti bazë (të dhënë-mundet me qene viti paraardhës ose cili vit caktohet si vit bazë).

Taksat mbi produktet dhe importin: Taksat mbi produkte janë taksat e pagueshme për njësi të disa mallrave dhe shërbimeve si Taksa mbi Vleren e Shtuar (TVSH), akciza, taksa dhe taksa doganore mbi importet.

Subvencione në produkte: Subvencionet në produkte janë pagesat e pakthyeshme që njësitë e administratës publike bëjnë tek ndërmarrjet si një shumë e caktuar parash për njësi të një malli ose shërbimi. Subvencionet në importe konsistojnë në subvencionimin e mallrave ose shërbimeve që bëhen të pagueshme kur malli kapërcen kufirin e territorit ekonomik ose kur shërbimet i janë kaluar njërive institucionale rezidente.

Konsumi Final: Konsumi Final është një nga komponentët kryesorë të PBB. Ky konsiston në mallrat dhe shërbimet e përdorura nga familjet individuale ose komunitetet dhe llogaritet si shumë e konsumit final të familjeve, konsumit final të administratës publike dhe konsumit final të Institucioneve Jo- Fitimprurëse në Shërbim të Familjeve (IJFSHF).

Konsumi final i familjeve: Llogarit të gjitha mallrat dhe shërbimet që përdoren direkt për të plotësuar kërkesat individuale të familjeve rezidente.

Konsumi final i administratës publike dhe Institucioneve jo fitim prurëse: Përmban vlerën e shërbimeve jotregtare të kryera nga administrata publike dhe nga institucionet jofitimprurëse në përfitim të komuniteteve ose grupe familjesh.

	<p>Eksporti neto: Eksporti neto llogaritet si diferencë midis eksportit të mallrave dhe shërbimeve (f.o.b) dhe importit të mallrave dhe shërbimeve (f.o.b).</p> <p>Formimi Bruto i Kapitalit Fiks: Konsiston në shpenzimet e kryera për kapitale të reja ose për shpenzime të tjera specifike kryer nga prodhuesit në sende ose shërbime me qëllim që të mbajnë rrisin ose zgjerojnë kapacitetin e tyre prodhues ose që të krijojnë kushte të reja përpunimi në të ardhmen.</p> <p>Çmim bazë: Shuma që prodhuesi merr nga blerësi për njësi të produktit apo shërbimit të prodhuar, pa tatimet dhe subvencionet mbi produktin. Çmimi bazë përjashton shpenzimet e transportit të faturuara më vete.</p> <p>Çmimet e tregut: janë çmimet pasi shtohen taksat mbi produktet minus subvencionet mbi produktet.</p> <p>Çmime korente: Çmimet e periudhës referuese. Ato përfaqësojnë çmimin e paguar për të mirat dhe shërbimet në kohën e prodhimit ose të konsumit.</p> <p>Çmime konstante: Vlerësimet me çmime konstante janë në vlerë reale pra të korigjuara për ndryshimet në çmime në lidhje me një vit bazë. Ato janë një mënyrë për të matur ndryshimin real në prodhim.</p>
3.5. Njësia statistikore	<p>Sipas udhëzimeve të ESA 2010, në llogaritë kombëtare përdoren dy lloje njësisish dhe dy mënyra përkatëse të ndarjes së ekonomisë: (a) njësi institucionale; (b) njësia e llojit të veprimtarisë lokale (KAU lokale). Lloji i parë përdoret për të përshkruar të ardhurat, shpenzimet dhe flukset financiare, si dhe bilancet. Lloji i dytë i njësive përdoret për përshkrimin e proceseve të prodhimit, për analizën e input-output dhe për analizën rajonale. Një njësi institucionale është një entitet ekonomik i karakterizuar nga një autonomi vendimmarrëse në ushtrimin e funksionit të tij kryesor. Një njësi rezidente konsiderohet se përbën një njësi institucionale në territorin ekonomik, ku ka qendrën e saj të interesit kryesor ekonomik, nëse ka një autonomi vendimmarrëse dhe/ose mban një grup të plotë llogarish, ose është në gjendje të hartojë një grup të plotë llogarish.</p> <p>Në llogaritë kombëtare shqiptare, llogaria e prodhimit bazohet në njësinë e ndërmarrjes; llogaritë rajonale në LKAU. Në llogaritë e sektorit, njësia institucionale është njësia e ndërmarrjes.</p>
3.6. Popullata statistikore	<p>Popullata e llogarive kombëtare të një vendi përbëhet nga të gjitha njësitë statistikore rezidente (njësia e ndërmarrjes, LKAU, shiko seksionin 3.5). Një njësi konsiderohet njësi rezidente e një vendi kur ka një qendër të interesit mbizotërues ekonomik në territorin ekonomik të atij vendi, domethënë kur angazhohet për një periudhë të zgjatur (një vit ose më shumë) në aktivitete ekonomike në këtë territor.</p> <p>Llogaritë kombëtare janë gjithërfshirëse. Kjo nënkupton që të gjitha njësitë statistikore rezidente janë të përfshira.</p>
3.7. Zona e referencës	<p>Zona e referencës për Llogaritë Kombëtare tremujore është ekonomia gjithsej e një vendi. Ekonomia gjithsej e një vendi mund të ndahet në rajone. Klasifikimi NUTS siguron një ndarje të vetme, të njëtrajtshme të territorit ekonomik të Shteteve Anëtare të BE-së. Llogaritë rajonale në Shqipëri përpilohen gjithashtu sipas këtij klasifikimi, në nivel NUTS 2/3.</p>

3.8. Mbulimi në kohë	<p>Të dhënat e llogarive kombëtare tremujore përpilohen në frekuencë tremujore.</p> <p>Programi i transmetimit ESA 2010 kërkon të dhëna, duke filluar prej vitit 1995T1 (tremujore), por aktualisht disa seri të llogarive kombëtare tremujore, fillojnë më vonë. Nëse ekzistojnë të dhëna të mëparshme, ato mund të jenë përpiluar sipas versioneve të mëparshme të ESA dhe mund të paraqesin përplasje konceptuale me ato të përpiluara nën ESA2010.</p> <p>Të dhënat e P.B.B-së tremujore datojnë duke filluar nga viti 2008 T1 (tremujore), e në vazhdim.</p>
3.9. Periudha bazë	<p>Koncepti i "periudhës bazë" nuk zbatohet në llogaritë kombëtare. Në vend të kësaj, për disa variabla të llogarive kombëtare zbatohen konceptet e çmimeve të vitit të kaluar dhe vëllimet e lidhur-zinxhir, siç përcaktohet në Vendimin e Komisionit 98/715 / EC. Llogaritja e variablave me çmimet e një viti më parë mundëson vlerësimin e indekseve të vëllimit midis periudhës kohore aktuale dhe një viti më parë. Pasi është përcaktuar periudha e referencës, indekset e vëllimit mund të lidhen zinxhir dhe më pas të aplikohen për variablat me çmimet aktuale të vitit të referencës. Kjo gjeneron vlerësime të vëllimit për çdo periudhë të analizuar.</p> <p>Llogaritë Kombëtare Tremujore, për të patur një qasje më të mirë me Llogaritë Kombëtare Vjetore dhe duke iu përmbajtur ESA 2010, vlerësojnë treguesit e volumit të serive kohore tremujore duke i vlerësuar me çmimet mesatare të vitit të mëparshëm dhe të lidhur-zinxhir (chain-linking), në vitin referencë, (2010=100), duke mundësuar që periudha të ndryshme të jenë të krahasueshme në mënyrë të vazhdueshme dhe të sigurojnë vlerësime për periudha afatgjata. Lidhja zinxhirë e shifrave tremujore kryhet duke përdorur teknikën Vjetore të Mbivendosjes, p.sh. vlerat e treguesve me çmimet e vitit të kaluar janë zvogëluar në nivelin e çmimit mesatar të vitit referencë të zgjedhur, duke përdorur deflatorë vjetore..</p>
4. Njësia matëse	<p>ESA 2010 tregon të gjitha flukset dhe stoqet në terma monetarë: në euro ose monedhë tjetër kombëtare. Sipas ESA 2010 vlerësimi i treguesve duhet t'u referohet çmimeve të tregut.</p> <p>Përveç matjes në çmimet aktuale (të tregut), disa variabla të llogarive kombëtare shprehen gjithashtu në çmimet e vitit të kaluar dhe vëllimet e lidhura zinxhir. Gjithashtu, është e mundur të përlllogariten norma rritje apo indekse, si dhe matje të tjera psh. Përqindje, të dhëna për banor, të dhëna të shprehura në standardet e fuqisë blerëse.</p> <p>NORMA E RRITJES REALE, krahasuar (%) me të njëjtin tremujor të vitit të mëparshëm (chain-linked), referencë viti 2010 (2010=100) për P.B.B tremujor sipas metodës së prodhimit dhe metodës së shpenzimeve.</p> <p>Përjashtim bëjnë disa variabla të tilla si popullsia apo punësimi, të cilët shprehen zakonisht në numër personash, orë pune ose pozicione.</p>
5. Periudha e referencës	<p>Periudha e referencës për P.B.B-në tremujore është tremujore nga 1 Janar - 31 Dhjetor 2021. Ky raport i referohet vitit 2021.</p>
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>➤ Baza ligjore në nivel kombëtar për prodhimin e P.B.B-së tremujore konsiston</p>

	<p>në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2017-2021 <p>➤ Baza ligjore përkatëse në nivel Evropian konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e (BE) Nr. 549/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, data 21 Maj 2013, "Për Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale në Bashkimin Evropian". • Sistemin Evropian të Llogarive ESA 2010, Programi i trasmetimit të të dhënave.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Të dhënat e P.B.B-së tremujore transmetohen çdo tremujor në EUROSTAT nëpërmjet platformës eDAMIS, dhe nëpërmjet platformës e-GDDS realizohet dërgimi i tyre në FMN.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura nga ndërmarrjet konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i</p>

	drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendari i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve	Kalendari i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesit i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr 17/2018, datë 17.04.2018 “Mbi Statistikat Zyrtare”, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Njoftimi për shtyp; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikime 4. Seksioni Kërkesa të dhënash.
9. Shpeshësia e shpërndarjes	Shpeshësia e shpërndarjes së të dhënave kryet me frekuencë tremujore.
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftim për media përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë si: P.B.B sipas metodës së prodhimit dhe komponentë kryesorë të P.B.B sipas metodës së shpenzimeve. Formatit i njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos dhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp për P.B.B-në tremujore publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Përdoruesit mund t'i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT në temën: <ul style="list-style-type: none"> • Llogaritë Kombëtare Tremujore
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë Shqip dhe Anglisht përmes sistemit Pc-Axis. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: Databaza Statistikore .
10.4. Aksesit në të dhënat mikro	Nuk aplikohet. Të dhënat mbi të cilat bazohet P.B.B-në tremujore janë të dhëna shumë burimore; administrative dhe vrojtme të ndryshme dhe si të tilla, niveli

	më i detajuar i të dhënave që disponohet për P.B.B-në tremujore është në nivel makro.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për Kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	<p>Kuadri i përgjithshëm metodologjik për përpilimin e llogarive kombëtare në BE është ESA 2010. Konceptet dhe metodologjia e përpilimit të llogarive kombëtare tremujore bazohet në metodologjinë e Eurostat (Handbook on quarterly national accounts, Handbook on prices and volumes measures in national accounts, European Statistical System (ESS guidelines on seasonal adjustment) dhe ka të njëjtat koncepte si llogaritë kombëtare vjetore.</p> <p>Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me Metodologjinë mbi P.B.B-në tremujore.</p>
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Spektori i Llogarive Kombëtare tremujore dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat mbi P.B.B-në tremujore për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	<p>INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “Për statistikën Zyrtare”, Nr.17/2018, datë 17.04.2018”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.</p>
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Kontrollet e cilësisë dhe vlerësimi i të dhënave janë veprime që kryhen përgjatë tërë procesit dhe më pas analizohen nga stafi me qëllim përmirësimin e cilësisë së statistikave. Të dhënat ekzistuese nga burimet administrative ose statistikore analizohen për përputhshmërinë e metodologjisë, periodicitetin, afatet kohore. Gjithashtu analizohen burimet e reja të informacionit që mund të përdoren në përpilimin e llogarive kombëtare tremujore dhe analizohet përputhshmëria e këtyre të dhënave me kërkesat e llogarive kombëtare tremujore.</p> <p>Të dhënat tremujore që janë përdorur për vlerësimin e P.B.B-së tremujore janë kryesisht të dhëna administrative si dhe të dhëna të marra nga anketat tremujore që kryhen nga INSTAT. Këto seri janë gjithmonë subjekt i revizionimeve të ardhshme, gjë e cila lidhet me përmirësimin dhe shtimin e informacionit në kohë.</p>

	<p>Rishikimi, vlerësimi dhe transformimi i të dhënave të LLKT kryhet sipas koncepteve dhe definicioneve të Llogarive Kombëtare, ESA2010 për secilin nga variablat. Për të kontrolluar dhe analizuar cilësinë e të dhënave ndiqen hapat e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Kontrolli matematik i të dhënave; – Kontrolli logjik i të dhënave; – Krahasimi i të dhënave individuale në seri kohore; – Krahasimi i burimeve të ndryshme të të dhënave.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit kryesorë të Llogarive Kombëtare tremujore kryesisht janë një numër përdoruesish të kualifikuar si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fondi Monetar Ndërkombëtar • Eurostat • Banka Botërore • Banka e Shqipërisë • Ministria e Financës dhe e Ekonomisë <p>Përdorues të tjerë të Llogarive Kombëtare tremujore janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Universitetet • Kërkuesit Shkencor • Studiuesit ekonomikë, Analistë • Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikime (Page Views) në lidhje me Llogaritë Kombëtare (P.B.B) për vitin 2021 janë rreth 45,373 klikime.</p> <p>Gjatë 2021 INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Llogarive Kombëtare (P.B.B) është vlerësuar me 3.58 (71.6%) nga një shkallë prej 1 (shumë e dobët) në 5 (shumë e mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Në shumicën e vendeve, llogaritë kombëtare mbulojnë agregatet kryesore të llogarive kombëtare, llogaritë e qeverisë, llogaritë sektoriale, llogaritë rajonale dhe tabelat e burim-përdorimit. Sidoqoftë, përmbajtja e të dhënave për këto fusha si dhe (detajet e) ndarjet e ndryshme (sipas rajonit, sektorit, industrisë, produktit, etj.), mund të jenë të ndryshme në vende të ndryshme, në varësi të nevojave kombëtare dhe burimeve të disponueshme. Programi i transmisionit ESA 2010, i përbërë nga 22 tabela në të gjitha fushat e llogarive kombëtare (shiko seksionin 10.3), përcakton grupin minimal të të dhënave të Llogarive Kombëtare që duhet të jenë të disponueshme në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së.</p> <p>Për përshkrime më të hollësishme të Llogarive Kombëtare Shqiptare, ju lutemi referojuni seksionit 19.</p>
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Pas përfundimit të procesit të mbledhjes së të dhënave nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë INSTAT, të dhënat kontrollohen për gabime të mundshme dhe lidhjet llogjike midis variablave, nëse të dhënat kanë probleme, sektori</p>

	<p>mundohet të qëndroj në kontakt me njësitë raportuese duke kërkuar që plotësimi i të dhënave të trajtohen me prioritet më të lartë.</p> <p>Në rastin kur të dhënat nuk vijnë në afatin e përcaktuar, vijnë të paplota, ka një ndryshim në metodologjinë e përpilimit apo ka mungesë qartësie kontaktohet direkt me personin përgjegjës.</p> <p>Të dhënat pasi merren nga Institucionet apo Sektorët përgjegjës ruhen në bazën e të dhënave. Duke lidhur informacionin e bazës së të dhënave, krijohen skedarët e gatshëm për procesim, të cilët i nënshtrohen kontrollit të plotësisë dhe cilësisë. Në rast se në këtë fazë kuptohet nga analiza e përgjithshme se ka mungesë të dhënash apo të dhënash jo të plota rikontaktohen sërish institucionet përkatëse.</p>								
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet.								
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse apo sektorët përkatës brenda INSTAT rishikojnë të dhënat e dërguara pranë sektorit të Llogarive Kombëtare 3-mujore për efekt përditësimi apo ndonjë gabimi të mundshëm human. Nëse institucionet/ sektorët përkatës rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit. Ky sqarim do të jetë në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT.</p>								
14. Afatet kohore dhe përpikmëria									
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet për P.B.B-në tremujore janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 90 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 90 ditë). Periudha referuese e rezultateve të P.B.B-së tremujore është 31 Dhjetori 2021.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>90</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2021	Data e publikimit	3/31/2022	Afatet kohore	90		
Periudha referuese	12/31/2021								
Data e publikimit	3/31/2022								
Afatet kohore	90								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat për P.B.B-në tremujore, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Statistikave të P.B.B-së tremujore ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>3/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2021	Data e shpallur	3/31/2022	Data e publikimit	3/31/2022	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2021								
Data e shpallur	3/31/2022								
Data e publikimit	3/31/2022								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>Krahasueshmëria gjeografike e llogarive kombëtare në shtetet anëtare të BE-së sigurohet me aplikimin e përkufizimeve të përbashkëta të Sistemit Evropian të Llogarive ESA 2010). Krahasimi gjeografik është gjithashtu i mundur në të gjithë botën, pasi shumica e vendeve jo-evropiane zbatojnë udhëzimet e SNA 2008 dhe SNA 2008 është në përputhje me ESA 2010.</p>								

15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Të dhënat e P.B.B-së tremujore datojnë që nga viti 2008T1 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 14 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=14).</p> <p>Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.</p>
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Llogaritjet e P.B.B-së tremujore janë konsistente me Llogaritë Kombëtare Vjetore si dhe janë të bazuara në të njëjtat koncepte dhe parime.
15.4. Koherenca e brendshme	Në vlerësimin e output-it kontrollohet konsistenca e brendshme e të dhënave para se output-i të finalizohet. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e tyre. Gjithashtu bëhen kontrole më të detajuara në nivel makro.
16. Kostoja dhe ngarkesa	Stafi i përfshirë në përgatitjen e Statistikave të P.B.B-së tremujore pranë sektorit të Llogarive Kombëtare 3 mujore është: 4 punonjës pranë zyrave qendrore të INSTAT. Me vlerësimet e tabelave të reja kërkesë e ESA 2010, është shtuar ngarkesa e stafit.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revizionimit • Politika e trajtimit të gabimeve
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Një nga momentet më kryesore të serive të të dhënave tremujore janë revizionimet e tyre. Këto revizionime janë me frekuenca të ndryshme që në përgjithësi ndahen në tre grupe kryesore:</p> <p>Revizionime Tremujore</p> <p>Të dhënat që bëhen të disponueshme për tremujorin e fundit kanë efekt edhe në revizionimin e tremujorëve paraardhës sepse me ardhjen e të dhënave për tremujorin e fundit vijnë edhe një sërë të dhënash të përditësuara për tremujorët e mëparshëm si rezultat i përmirësimeve të tyre apo ndryshimeve administrative. Duhet theksuar fakti që të dhënat që përdoren për vlerësimin e P.B.B-së Tremujore janë kryesisht të dhëna administrative. Futja e të dhënave të tremujorit të fundit në seri dhe më pas zhveshja e serisë së re nga efektet sezonale sjell edhe disa ndryshime për tremujorët e afërt të mëparshëm.</p> <p>Revizionime Vjetore</p> <p>Duke qenë se vlerësimi i P.B.B-së Tremujore mbështetet në të dhënat vjetore, ndryshimet që do të ndodhin në P.B.B Vjetore do të reflektohen dhe në seritë tremujore. Ndryshimet vjetore vijnë si rezultat i përmirësimeve të burimeve ekzistuese vjetore apo të përfshirjes së burimeve të reja. Vlerësimi i një viti kalon në disa etapa derisa arrin vlerësimi final i tij. Ndryshimet që ndodhin në këto etapa reflektohen dhe në seritë tremujore. Efektet e ndryshimeve vjetore duke qenë se kanë një mospërputhje kohore relativisht të gjatë (vjetorja gjysmë finale del t+15 muaj më vonë dhe finalja 27 muaj më vonë), japin një efekt më</p>

	<p>të madh dhe më të shtrirë në kohë në seritë tremujore.</p> <p>Revizionime Metodologji Përgjithësisht këto lloj revizionimesh janë si pasojë e ndryshimeve ose përmirësimeve metodologjike që ndodhin si në Llogaritë Kombëtare Vjetore ashtu edhe në Llogaritë Kombëtare Tremujore që në të dy rastet do të kenë efektet e tyre në seritë tremujore. Gjithashtu këto lloj revizionimesh mund të vijnë dhe kur burime të reja të dhënash bëhen të disponueshme, të cilat do të zëvendësojnë ato të mëparshmet.</p>
<p>18. Përpunimi statistikor</p>	
<p>18.1. Burimi i të dhënave</p>	<p>Të dhënat e marra brenda Institucionit. Të dhënat merren në afatet kohore të planifikuara në secilin aktivitetet statistikor të INSAT sipas fazave respektive. Këto të dhëna përdoren si input në sistemin e përpilimit të llogarive kombëtare tremujore duke bërë lidhje direkte</p> <p>Të dhënat administrative të marra nga Institucione të tjerë. Me institucionet prodhues të këtyre të dhënave, janë nënshkruar Memorandume Mirëkuptimi për marrjen e të dhënave në formate dhe afate kohore të përcaktuara.</p>
<p>18.2. Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave</p>	<p>Shpeshësia e grumbullimit të të dhënave realizohet me frekuenca tremujore.</p>
<p>18.3. Grumbullimi i të dhënave</p>	<p>Të dhënat e marra brenda Institucionit kryesisht janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dhënat nga sektori i statistikave afatshkurtra (ATN, Tregtia me pakicë, • Të dhënat nga sektori i Çmimeve: Indekset e çmimeve (IÇK, ICP, IKN, ICE, ICI); • Të dhënat nga drejtorja e Bujqësisë (Prodhimi dhe Çmimet për Bujqësinë, Pyje dhe Peshkim); • Të dhëna për Administratën, Arsimin dhe Shëndetësinë Publike; • Të dhënat e tregtisë së jashtme; • Anketa e forcave të punës (AFP); • Anketa e buxhetit të familjeve (ABF); • Marrja e të dhënave mbi vlerësimet vjetore të PBB-së me metodën e prodhimit dhe shpenzimeve. <p>Sektori përgjegjës për përpilimin e të dhënave i vendos në një skedar sipas një formati dhe afati kohor të dakordësuar. Këto të dhëna përdoren si input në sistemin e përpilimit të llogarive kombëtare tremujore duke bërë lidhje direkte.</p> <p>Të dhënat administrative të marra nga Institucione të tjerë kryesisht janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bilanci i Pagesave (Banka e Shqipërisë); • Të dhënat e energjisë (KESH, OSSHE, OST); • Agjencia kombëtare e burimeve natyrore (Prodhimi dhe investimet për aktivitetin e kërkimit për hidrokarbure); • Të dhënat për aktivitetin Financiar (BSH dhe vlerësuar nga SLLKV); • Të dhënat nga skedari i TVSH, TF dhe Sigurimet shoqërore; • Të dhënat nga skedari i AMF. <p>Të dhënat ruhen në bazën e të dhënave, dhe më pas kodifikohen, analizohen dhe</p>

	janë gati për vlerësimin e komponentëve të llogarive kombëtare tremujore.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Vijueshmëria e llogaritjeve</p> <p>Vlerësimi i llogarive kombëtare tremujore ndjek hapat që vijojnë më poshtë dhe për secilin hap ndërtohen skedarët, duke bërë dhe lidhjet për qarkullimin e informacionit. Në metodën indirekte radha që ndiqet për të vlerësuar V.SH.B-në tremujore mund të jetë e ndryshme, por ajo më e përdorura vijon si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> i) Mbledhja dhe plotësimi i të dhënave tremujore me çmime korrente dhe konstante nga burime të ndryshme të dhënash. ii) Krijimi i serive kohore për të dhënat tremujore në mënyrë që periudhat e ndryshme të jenë të krahasueshme mes tyre. iii) Kalibrimi (Benchmarking) i serive të të dhënave tremujore të pa zhveshura nga efektet sezonale, me serinë e të dhënave vjetore, veç e veç për seritë me çmimet korrente dhe konstante. iv) Agregimi i të dhënave tremujore e më pas eliminimi i efekteve sezonale të tyre, veç e veç për seritë me çmimet korrente dhe konstante. <p>Vlen për t'u theksuar fakti që shuma e katër tremujorëve të zhveshur nga efektet e sezonalitetit jo domosdoshmërisht duhet të jetë e barabartë me vlerën vjetore të P.B.B- së. Kjo vjen për praninë e efekteve sezonale që janë të pranishme në seritë tremujore.</p>
18.5. Përpilimi i të dhënave	<p>Vlerësimi me çmime konstante</p> <p>Llogaritë Kombëtare Tremujore, për të patur një qasje më të mirë me Llogaritë Kombëtare Vjetore dhe duke iu përmbajtur ESA 2010, vlerësojnë treguesit e volumit të serive kohore tremujore duke i vlerësuar me çmimet mesatare të vitit të mëparshëm dhe të lidhur-zinxhir (chain-linking), në vitin referencë, (2010=100).</p> <p>Procedura e përgjithshme e vlerësimit të treguesve të volumit të serive kohore tremujore ndjekin këto hapa: Se pari, treguesit me çmime korrente janë konvertuar në çmimet mesatare të vitit të kaluar duke përdorur indekset përkatëse të çmimeve. Në vijim, treguesit e vlerësuar me çmimet mesatare të vitit të kaluar janë lidhur-zinxhir (chain-linking), në vitin referencë, (2010=100), me qëllim që të sigurohet një seri kohore e krahasueshme në terma volumi. Kjo qasje u prezantua për herë të parë në llogaritë tremujore gjatë publikimit të tremujorit të parë 2014. Në të kaluarën është aplikuar një qasje e ndryshme, ku të dhënat aktuale të çmimeve janë konvertuar në çmime konstante të vitit bazë fikse (viti bazë ka qenë 2005).</p> <p>Lidhja-zinxhir (chain-linking) e serive tremujore është kryer duke përdorur teknikën “Annual overlap”, pra shifra me çmime të vitit të mëparshëm janë qasur në nivelin e çmimeve mesatar të vitit referues të zgjedhur duke përdorur deflatorë vjetore. Kjo teknikë përdoret në shumicën e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Lidhja-zinxhir (chain-linking) nënkupton vlerësimin e treguesve të volumit për periudhën afatgjatë duke akumuluar ndryshimet e indekseve për periudhat afat shkurtra me bazë të ndryshme. Seritë kohore “chain-linking” të P.B.B-së tremujore me periudhën referuese fikse (2010=100) lejojnë periudhat e ndryshme të krahasohen në mënyrë konsistente dhe të sigurojë matjen e ndryshimeve afatgjata të volumeve. Megjithatë, përdoruesit</p>

	<p>duhet të jenë të vetëdijshëm për fenomenin që këto seri nuk mund të jenë të mbledhshme si shumë e komponentëve përbërës (non-additivity problem).</p> <p>P.sh, në qoftë se seritë kohore tremujore të P.B.B-së tremujore me çmime korrente dhe me çmimet konstante mesatare të vitit të mëparshëm janë të mbledhshme (additive), ku P.B.B-ja totale është shumë e komponentëve, ndësa për seritë kohore “chain-linking” me periudhën referuese fikse (2010=100) P.B.B-ja totale nuk mund të mblidhet si shumë e komponentëve përbërës (non-additive).</p> <p><i>Norma e rritjes reale, vleresohet duke përdorur seritë tremujore të lidhura-zinxhir (chain-linking), në vitin referencë (2010=100).</i></p> <p>Procesi i Kalibrimit (Benchmarking)</p> <p>Qëllimi kryesor i këtij procesi është që të sigurohet që llogaritë tremujore të jenë konsistente me llogaritë vjetore.</p> <p>Konsistenca midis këtyre dy llogarive mund të bëhet me çmime korrente dhe konstante, ku si vlerat tremujore ashtu dhe ato vjetore janë të shprehura me çmime të të njëjtit vit bazë. Është për tu theksuar fakti që ky proces ruan trendin e indikatorëve tremujorë duke dhënë në këtë mënyrë ndryshimet në volum të axhustuara.</p> <p>Kalibrimi i shifrave tremujore të P.B.B-së (nga Tr1 2008 deri në Tr4 2019), me të dhënat vjetore për periudhën 2008-2019, është kryer duke përdorur programin XLPBM në excel. Ky program është zhvilluar nga FMN, dhe aplikon një sërë teknikash matematikore dhe statistikore të cilat përdoren për kalibrimin e serive kohore tremujore me ato vjetore. Gjatë procesit të kalibrimit, mospërputhjet midis të dhënave tremujore dhe të dhënave vjetore minimizohen. Rezultati është arritja e konsistencës së të dhënave tremujore dhe vjetore, shumat e të dhënave tremujore është e barabartë me të dhënat vjetore për të gjitha vitet e kalibruara (benchmarking).</p>
18.6. Rregullimi	<p>Zhveshja nga sezonaliteti: Një nga karakteristikat më të rëndësishme të serive tremujore është prania e sezonalitetit në to. Ekzistojnë dy mënyra për të eliminuar efektet sezonale nga seritë tremujore.</p> <p>Mënyra indirekte: Niveli i detajimit, në të cilin një seri është zhveshur nga sezonaliteti, është e rëndësishme pasi kjo ndikon në cilësinë e serisë. Seritë individuale të degëve të ndryshme të ekonomisë mund të zhvishen nga efektet sezonale dhe më pas të agregohen në degë më të mëdha. Kjo metodë konsiderohet si metodë indirekte. Metoda indirekte ka avantazhin se i ruan më mirë efektet sezonale të një serie individuale, por kjo vetëm me çmime korrente sepse me çmime konstante ky efekt zbehet për shkak të ndikimit të indekseve zinxhir që krijohen.</p> <p>Mënyra direkte: Një mënyrë tjetër është që degët e ekonomisë të agregohen fillimisht në degë më të mëdha e më pas të zhvishen nga efektet sezonale. Kjo mënyrë është quajtur mënyra direkte e zhveshjes së efekteve të sezonalitetit.</p> <p>Metoda direkte mund të japë rezultate më të mira nëse degët individuale të</p>

	<p>ekonomisë kanë efekte të ngjashme sezonale me njëra tjetrën. Sa më të detajuara të merren seritë e të dhënave aq më e madhe është diferenca midis faktorëve jo të rregullt të një serie dhe atyre të zhveshur nga sezonaliteti, gjë e cila mund të humbasë objektivin kryesor që kanë efektet sezonale.</p> <p>Në një vend si Shqipëria ngjarjet jo të rregullta mund të kenë një ndikim të madh në të dhëna të caktuara. Gjithsesi nëse komponentët përbërës të një serie kanë të njëjtin sezonalitet, agregimi zbut efektet e komponentëve jo të rregullta. Kjo është domethënëse për rastin e Shqipërisë ku shumë seri ekonomike ndikohen nga fluktacionet e njëjta sezonale të një dege. INSTAT përdor mënyrën direkte për përshtatjen sezonale të serive kohore tremujore.</p> <p>Programi që INSTAT përdor për përshtatjet sezonale të serive kohore është JDemetra+, metoda TRAMO/SEATS, ky program është zhvilluar nga EUROSTAT.</p>
<p>19. Komente</p>	
<p>Aneks</p>	
<p>Implementimi i Esa 2010 dhe NVE Rev.2 Albania Përpilimi i Llogarive Kombëtare Tremujore Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve Kalendari i Publikimeve Programi i Statistikave Zyrtare 2017-2021 Liqi Për Statistikat Zyrtare Statistika bankare</p>	